



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 8/1, datë 23.07.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 11:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 23.07.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje!

Të nderuar këshilltar! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës. Në këtë mbledhje siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë ku pjesën më të madhe të tyre e zënë projektvendime në lidhje me fatkeqësinë natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Ftoj sekretaren të procedojë me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

34 Këshilltarë në sallë.

(V.O. *Hyn me vonesë në sallë këshilltarët Dorian Isaj dhe Jonuz Myshketa* . Gjithsej në mbledhje 36 këshilltarë).

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen, se sot kemi 17 pika në rendin e ditës.

Disa janë tërhequr nga propozuesi. Po filloj me leximin e rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 63, DATË 17.03.2023, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.130, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 99, DATË 30.03.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 37, DATË 09.05.2022, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, PALLATI NR.32 RRUGA "HYSEN KËRTUSHA", I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” I NDRYSHUAR
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 16, DATË 21.05.2025 PËRSA I PËRKET Z. ILIA TRAJA DHE ZNJ. MERITA TRAJA
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN MYSHKETA", PALLATI NR. 25.1, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, 6, SUKTH, MANËZ, ISHËM, RRASHBULL DHE KATUND I RI BASHKIA Durrës, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE

	TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TREMBËDHJETË PARAPRAKE TË 48 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË QËNDRUESHËM PËR ENERGIJË DHE KLIMËN (SECAP) TË BASHKISË DURRËS 2030
Pika 10 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1581683 (NJË MILION E PESËQIND E TETËDHJETË E NJË E GJASHTËQIND E TETËDHJETË E TRE) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI INTERREG IPA ADRION (2021-2027)
Pika 11	Hiqet nga rendi ditës
Pika 12	Hiqet nga rendi ditës
Pika 13	Hiqet nga rendi ditës
Pika 14	Hiqet nga rendi ditës
Pika 15	Hiqet nga rendi ditës
Pika 16 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 16, DATË 21.05.2025 PËRSA I PËRKET ZNJ. DAJANA LUMI, Z. LIRIM MURRJA DHE Z. MENTOR MUJA
Pika 17	Hiqet nga rendi ditës
Pika 18 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT, QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2025
Pika 19. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË KONTRATËS PËR VITIN 2025
Pika 20 shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUJIN KORRIK 2025
Pika 21. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 25, DATË 03.02.2023 , VKB-SË NR. 85, DATË 29.07.2024, VKB-SË NR. 190, DATË 22.12.2023 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË CILËT DO PËRFITOJNË SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 22 shtesë	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 166, DATË 23.12.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE, TË MASËS SË GRANTIT TË

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN NË NJË PROGRAM TJETËR
Pika 23. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.119, DATË 27.10.2022, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE PËR RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR

Keni ndonjë koment?

Jeni dakord me rendin e ditës?

Kalojmë në votim. Kush është pro?

Atëherë, me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime rendi i ditës.

I jepet fjala për projektvendimin e ...

.....Kërkon fjalën Flurura Kasa.....

Flutura Kasa: Meqenëse të lashë të lexojë këtë rendin e ditës, për ta dëgjuar më shumë këto të medias dhe të ftuarit që janë këtu, desha vetëm të falënderoj pak opozitën për largesën që bëri herën tjetër, se i qan barku shumë në fakt, se këto janë shumica për tërmetin dhe ndihmën ekonomike për familjet në nevojë. Kështu që edhe nëse largohen prapë nuk është ndonjë ndryshim i madh.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kasa.

.....Kërkon fjalën Ardian Muka.....

Denisa Luarasi: Po, Muka, mund ta kërkosht?

Po, Muka, Ju lutem.

Ardian Muka: Mirëdita.

Po radhës tjetër, me të vërtetë, opozita u largua, u largua në shenjë proteste që Bashkia, por edhe pjesë e Këshillit, të vehen ne shina. Pra, atë çfarë ne kërkuam është që të gjithë materialet, në bazë të rregullores, duhet të vendosen në dispozicion 5 ditë punuese përpara se të zhvillohet mbledhja e Këshillit. Për fat të keq, në mbledhjen e kaluar erdhën 16 pika, u shtuan 6 pika, u hoqën 4 pika, u shtuan 2 të tjera, u hoqën edhe 4 të tjera, dhe erdhën 2 ditën e fundit. Për këtë, meqenëse ishte e përsëritur kjo si proces, neve protestuam në atë mënyrë që u larguam nga mbledhja e Këshillit. Ju thamë që jemi në dispozicion për çdo ditë ne mund të mbledhemi. Fakti që jemi këtu sot, jemi të mbledhur, aprovuam atë çfarë është ajo, protokollin e këshillit, kjo i mbledhjes. Neve jemi këtu për të vazhduar mbledhjen, por, meqenëse po ndërhyj. Në vëmendje të gjithëve, po ndërhyj, Këshilli Bashkiak, një nga detyrat kryesore të tij ka miratimin dhe aprovimin.....

Denisa Luarasi: Ke dhe 10 sekonda se e kalove.

Ardian Muka: ... e organigramës, pozicioneve të Bashkisë, si dhe rrogat. Një pyetje kisha për nënkryetarin këtu, meqenëse kryetarja nuk është e disponueshme.

Denisa Luarasi: Të lutem kalojmë në rendin e ditës.

Ardian Muka: Ka lidhje, sepse ne aprovuam rendin e ditës.

Denisa Luarasi: Ka lidhje se herë tjetër duhet ta bëni kërkesën me email, duhet të zbatoni rregulloren.

Ardian Muka: Janë pika shumë sensibil. Jemi këtu për t'i aprovuar, por duam të dimë nga ana e Bashkisë, administratorët e njësive bashkiake, nënkryetarët dhe drejtorët janë në funksionet e tyre? Sepse...

Denisa Luarasi: Të lutem vazhdojmë me rendin e ditës, të lutem.

Ardian Muka: Sepse na rezulton që prej një jave Kryeministri ka kërkuar shkarkimin e të gjithëve.

Denisa Luarasi: Mos me dil nga rendi i ditës.

Ardian Muka: Natyrisht, kryetaren e kemi kuptuar që e ka shkarkuar, sepse ka 10 mbledhje që nuk paraqitet.

Denisa Luarasi: Muka kemi pika për rindërtimin.

Ardian Muka: Dhe kryetar kemi vetëm një tani, Kryeministër dhe kryetar bashkisë, por na intereson për atë çfarë është gjithë piramida e bashkisë, janë apo jo në punë, sepse përndryshe ne aprovojme këtu projektvendime që kthehen në vendime, por nuk e di kemi infrastruktura për t'i zbatuar apo jo? Kaq. Faleminderit.

Elio Jani: Materialet e Këshillit që keni në dispozicion janë firmosur nga drejtorët e bashkisë së Durrësit. Janë të gjithë në punë. Kjo që ngrini ju nuk ka lidhje me mbledhjen, por të votojmë këto pika, sepse kanë më së shumti lidhje me rindërtimin. Largimi juaj i para 5 ditëve për njerëzit që kanë hall është 5 ditë jashtë shtëpive.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti nënkryetar.

- Jepet fjala për projektvendimin e **pikës 1**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Mund të flas?
Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Në lidhje me pikën 1, Komisioni me shumicë votash e miratoi dhe ne ftojmë Këshillin sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit e kalon në votim.

Denisa Luarasi:Faleminderit, zonja Mataj.

Komente, pyetje ka për pikën 1 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro?

Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 2**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, edhe në lidhje me pikën 2, Komisioni ynë e votoi me shumicë votash dhe propozon sot që të kalojë në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit, me shumicë votash, e kalon për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Komente? Pyetje kemi për pikën 2?

Kalojmë në votim.

Kush është pro?

Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe në lidhje me pikën 3, Komisioni ynë e votoi me shumicë votash dhe fton Këshillin ta votojë sot pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit, me shumicë votash, e kalon për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Komente, pyetje ka?

Kalojmë në votim?

Ok. Muka thërrite.

Po Muka

Ardian Muka: Këtu diskutohet për një pallat, i cili ndodhet në zonën e Stadiumit, është nr.32, në rrugën Hysen Kërtusha. Nga ana e banorëve, meqenëse pallati është dhënë si DS5, pra diskutohet këtu që do të shëmbet, pavarësisht që në pikë këtu diskutohet thjeshtë për një familje që është bashkëngjitur listës, dhe si të them është plotësuar ana dokumentare. Por banorët janë të shqetësuar, sepse një pjesë e mirë e tyre nuk kanë kërkuar strehim në ambientet e reja që Bashkia ka ndërtuar në zonën e Spitallës, Porto Romano, por ato kanë kërkuar që, kur pallati të rindërtohet, të rindërtohet në të njëjtin vend, sikurse është dhe projekti i bashkisë, ato të marrin zgjidhje, apartamente aty ku i kanë pasur, në të njëjtin vend. Për momentin, këta banorë nuk trajtohen për më shumë se një vit e gjysmë e më shumë me qira. Pyetja e tyre është: Si do të zgjidhet kjo situatë? Dhe besoj se edhe në shumë pika të tjera, por që ne nuk kemi informacionin e duhur, por janë banorët thashë që e kanë ngritur këtë si problem, por meqë po e diskutojmë nga ana e bashkisë mund të na jepni një përgjigje. Pra, banorët që nuk do të trajtohen me apartamente të reja, kanë kërkuar që të strehohen në të njëjtin pallat kur ai të rindërtohet. Për momentin nuk po trajtohen me qira prej një vit e gjysmë. Dhe këtu duket dhe ajo që tha edhe nënkryetari, që Bashkisë i bëhet vonë shumë, po si puna e këtyre ka shumë qytetarë megjithatë presim përgjigje. Faleminderit.

Elio Jani: Faleminderit për pyetjen.

Faktikisht prej banorëve nuk është që po e dëgjojmë për herë të parë këtë nga ju me thënë të drejtën. Ne kemi çdo ditë takime me banorët dhe banorët janë të qartë se ne i kemi sqaruar disa herë banorëve për pjesën e bonusit të qirasë. Për fat të keq, ka mbi dy vjet që ky program të themi është mbyllur. Bashkia nuk ka mundësi financiare për të përballuar bonusin e qirasë. Por me banorët kemi komunikuar dhe ata janë në dijeni të kësaj gjëje që ata shumë shpejt do të strehohen në pallatin e tyre ku ka qenë në të njëjtin vend.

Besoj se ju, si anëtarë të Këshillit, e keni kaluar një vendim për miratimin e fondit për ndërtimin e pallatit dhe jemi në pritje për të filluar procedurat. Besoj se brenda pak muajsh do të nisin procedurat e prokurimit për ato pallate atje. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Nënkyetar.

Të lutem thërrit mikrofonin se nuk regjistrohesh.

Ardian Muka: Po thoj që, nga momenti që do të shëmbet pallati, ne e kemi aprovuar fondin ka mbi 6 muaj edhe më shumë, pra në momentin që do të shëmbet pallati, pra pallati ekzistues, i cili është shpallur DS5 dhe deri në momentin që ndërtohet pallati i ri besoj që ikin nja tre vjet. Për tre vite ju po thoni që këta banorë nuk do të marrin me bonusin e qirasë? Faleminderit.

Elio Jani: Ju dhashë njëherë përgjigjen.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Muka.

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 3 të rendit të ditës?

Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 4**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, dhe në lidhje me pikën 4, si Komision, e votuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin ta votojë pro. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit, me shumicë votash, e kalon.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Mataj.

Komente apo pyetje për pikën 4 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 4?

Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 4.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe në lidhje me pikën 5, ne e votuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin të votojë pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi|: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, me shumicë votash, e kalon.

Denisa Luarasi :Faleminderit, zonja Mataj.

Komente apo pyetje ka për pikën 5?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 5 të rendit të ditës?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 6**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, dhe për pikën 6, ne e votuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin sot që t'i japë miratimin. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe për pikën 6, Komisioni i Strehimit ra dakord që të kalojë për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Ka komente apo pyetje ka për pikën 6?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 6?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 7**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, në lidhje me pikën 7, ne e votuam me shumicë votash.

Unë kam vetëm një saktësim, kryetare: duhet të hiqet pika për Njësinë 6, sepse mungon Aneksi 2. Në njësinë administrative nr. 6, Aneksi 2 mungon, kështu që ne e votuam duke mos e përfshirë, sepse nuk është bashkëngjitur aneksi.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit është dakord me propozimin e Komisionit Ligjor.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Ka komente apo pyetje?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 7 të rendit të ditës, me ndryshime?

Me 36 vota pro, miratohet me ndryshime edhe pika 7 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 8**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe në lidhje me pikën 8, ne e votuam me shumicë votash dhe kërkojmë miratimin nga Këshilli. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe për pikën 8, Komisioni i Strehimit e kalon me shumicë votash për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente, pyetje ka për pikën 8?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 8?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 8 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 9**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe në lidhje me pikën 9, ne e votuam me shumicë votash dhe kërkojmë miratimin nga Këshilli.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komisioni i Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve, zonja Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit, kryetare. Mirëdita të gjithëve.

Komisioni i Trajtimit të Mbetjeve dhe Mjedisit mori në shqyrtim pikën 9 dhe vendosi me shumicë votash që të sjelli për të kaluar “Planin e veprimit të qëndrueshëm për energjinë dhe klimën për Bashkinë e Durrësit”. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente, pyetje ka për pikën 9?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 9 të rendit të ditës?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 9.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 10**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe në lidhje me pikën 10, Komisioni ynë e votoi me shumicë votash dhe propozojmë sot të miratohet. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Komisioni i Buxhetit, Financave dhe Taksave - Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financave dhe Tarifave e aprovon me shumicë votash dhe e kalon për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi : Ka komente apo pyetje për pikën 10 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 10?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 10 e rendit të ditës.

- **Pikat 11, 12, 13, 14, 15** janë hequr nga rendi i ditës.
- Kalojmë me pikën 16 të rendit të ditës. I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 16**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, për pikën 16, komisioni ynë e votuam me shumicë votash dhe propozojmë që sot të marrë miratimin nga Këshilli.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit, për pikën 16, është dakord që të kalojë në votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Ka komente apo pyetje për pikën 16 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 16?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 16 e rendit të ditës.

- **Pika 17** është hequr nga rendi i ditës.
- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 18**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, në lidhje me pikën 18, Komisioni ynë e miratoi me shumicë votash dhe propozojmë që Këshilli sot të japë votën pro.

Denisa Luarasi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Komisioni i Strehimit, për pikën 18, ra dakord që të kalojë në votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente apo pyetje ka për pikën 18?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 18?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 18 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 19**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe për pikën 19, e miratuam me shumicë votash dhe kërkojmë miratimin e Këshillit sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit e kaloi me shumicë votash pikën 19 dhe ja kalon Këshillit për votim.

Denisa Luarasi: Ka komente apo pyetje për pikën 19?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 19?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 19 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 20**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonjës Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi: Edhe për këtë pikë komisioni jonë u mbledh dhe si gjithmonë dakordësoi që t'i kalojë Këshillit Bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Doçi.

Ka komente, pyetje për pikën 20 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 20?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 20 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 21**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe për pikën 21, ne dhamë miratimin si shumicë në komision dhe kërkojmë miratimin sot nga Këshilli. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit Zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj

Elisabeta Mataj: Komisioni i Strehimit, për pikën 21, e kalon për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Ka komente, pyetje për pikën 21 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 21?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 21 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 22**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zoti Dritan Rakipi.
Dritani të lutem ma thërrit pak mikrofonin.

Dritan Rakipi: U mbledh Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, me shumicë votash, i propozohet Këshillit Bashkiak votimi i pikës 22.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Rakipi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Edhe Komisioni i Strehimit është dakord që pika 22 të kalojë në votim në Këshillin Bashkiak me shumicë votash.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Ka komente për pikën 22 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 22?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 22 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 23**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zotit Dritan Rakipi.

Dritan Rakipi: Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, me shumicë votash, i propozon Këshillit Bashkiak kalimin e pikës 23.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Rakipi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Elisabeta Mataj.

Elisabeta Mataj: Komisioni i Strehimit ashtu si edhe pikat me përpara është dakord që të kalojë për votim pika 23.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mataj.

Komente apo pyetje ka për pikën 23 të rendit të ditës?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 23 të rendit të ditës?

Me 36 vota pro, miratohet pa ndryshime edhe pika 23 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** zonja Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Atëhere, përshëndetje sërish.

Unë kam kënaqësinë të ndaj me ju sot, përtej dallimeve politike, disa gjetje të rëndësishme që vijnë si rezultat i “Barometrit Gjinator” në nivel kombëtar. Ky barometër është një instrument vlerësimi dhe monitorimi për standardet e barazisë gjinore dhe të dhënat për Durrësin janë mbledhur në muajin janar, sigurisht, në bashkëpunim të ngushtë mes Aleancës së Grave Këshilltare dhe administratës së Bashkisë. Pas përpunimit të këtyre të dhënave, ne kemi identifikuar dy gjetje që do donim t’i ndanim me administratën e Bashkisë, në funksion të përmirësimit të dy aspekteve:

1. Duke punuar më shumë në drejtim të përmirësimit të përfaqësimit 30 % për zëvendëskryetarët e saj.
2. Dhe gjithashtu, për përmirësimin e përfaqësimit me 30 % për administratorët e njësive administrative.

Sa më sipër Aleanca kërkon që të krijohet mundësia që kjo gjë të jetë e mundur. Barazia gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një themel i demokracisë lokale dhe zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët. Faleminderit.

.....*Ardian Muka kërkon fjalën.....*

Ardian Muka: Në emër të grupit demokrat, doja të bëja një përmbyllje.

Pra siç u pa edhe sot, të gjitha projektvendimet që u sollën, u votuan me prozitivitet nga ana jonë, natyrisht edhe nga pjesa tjetër e Këshillit. Kjo tregon që nga ana e opozitës ka ndjesi ndaj qytetarëve dhe problematikave që ato kanë. Siç kemi thënë gjithmonë, sa herë që ka nevojë ne do të jemi këtu për të mbrojtur interesat e qytetarëve, natyrisht dhe interesat e qytetit. Faleminderit!

Denisa Luarasi : Faleminderit, zoti Muka.

Ju falenderoj për përkushtimin. Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe angazhimin.
Ju uroj pushime të gëzuara. Takohemi në shtator!

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 14 (katërmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Drejtuesi i seancës plenare, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i seancës Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak :	DENISA LUARASI
Sekretar i Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltar (Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak):	EDLIRA DEVOLLI
Këshilltar (Kr. Grupi) :	JONUZ MYSHKETA
Këshilltar (Zv/Kr. Grupi) :	LUAN NEZHA